



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË

PROJEKT VENDIM

Nr.        Datë \_\_/04/2026

**"PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT DHE TË RREGULLORES PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT 'HARTIMI DHE BOTIMI I ENCIKLOPDISË SË KOLONJËS DHE LESKOVIKUT 2025–2030"**

Në zbatim dhe mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise I ndryshuar, VKB nr.152 datë 22.12.2025 " Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Kolonjë per vititn 2026" me propozim të Kryetarit të Bashkisë , Këshilli i Bashkisë Kolonjë në mbledhjen e tij të datës 02/04/2026

**VENDOSI:**

1. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Kolonjë, Shoqatës Kulturore Patriotike "Kolonja" dhe Redaksisë Qendrore të Enciklopedisë së Kolonjës dhe Leskovikut, me objekt realizimin e projektit "Hartimi dhe botimi i Enciklopedisë së Kolonjës dhe Leskovikut 2025–2030".
2. Miratimin e rregullores "Për ngritjen dhe funksionimin e Redaksisë Qendrore dhe të redaksive të fushave", si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 3.Ngarkohet Bashkia Kolonjë që të mbështesë projektin me logjistikë dhe të kontribuojë financiarisht për realizimin dhe botimin e Enciklopedisë, të ndjekë ecurinë e projektit dhe të kërkojë raportim periodik me shkrim jo më pak se dy herë në vit.
4. Shoqata Kulturore Patriotike "Kolonja" ngarkohet me: organizimin dhe koordinimin e procesit të hartimit të enciklopedisë, administrimin e bashkëpunimit me autorët dhe grupet e punës dhe garantimin e ruajtjes dhe menaxhimit të dokumentacionit të projektit.
- 5.Redaksia Qendrore dhe redaksitë e fushave janë përgjegjëse për:
  - cilësinë shkencore dhe përmbajtjen e enciklopedisë;
  - përzgjedhjen e autorëve dhe materialeve;
  - përgatitjen përfundimtare për botim.
- 6.Administrimi i fondeve për projektin do të bëhet mbi bazën e një protokollit të veçantë bashkëpunimi ndërmjet palëve. Ky projekt ka një afat realizimi për periudhën 2025–2030.
- 7.Ky vendim hyn ne fuqi në mbështetje të ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

**KRYETARI I BASHKISË  
ERION ISAI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË

Nr. 2069 Prot

Ersekë, më 30.03.2026

RELACION  
PËR  
PROJEKT-VENDIM

Nr.      Datë      /04/ 2026

**"PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT DHE TË RREGULLORES PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT 'HARTIMI DHE BOTIMI I ENCIKLOPEDIË SË KOLONJËS DHE LESKOVIKUT 2025–2030"**

**TË NDERUAR!**

Në zbatim dhe mbështetje të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji nr.9936 date 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqiperise I ndryshuar, VKB nr.152 date 22.12.2025 " Miratimin e projektit dhe rregullores "Hartimi dhe botimi i Enciklopedisë së Kolonjës dhe Leskovikut për periudhën 2025–2030".

Ky projekt synon hartimin dhe botimin e një enciklopedie të plotë, e cila do të pasqyrojë vlerat historike, kulturore, arsimore dhe shkencore të zonës së Kolonjës dhe Leskovikut, duke kontribuar në ruajtjen, dokumentimin dhe promovimin e trashëgimisë vendore.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, propozohet miratimi i rregullores "Për ngritjen dhe funksionimin e Redaksisë Qendrore dhe të redaksive të fushave", si pjesë përbërëse e vendimit, e cila përcakton organizimin, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të strukturave përgjegjëse për realizimin e enciklopedisë.

Bashkia Kolonjë do të mbështesë realizimin e projektit përmes sigurimit të mbështetjes logjistike dhe kontributit financiar për hartimin dhe botimin e enciklopedisë. Gjithashtu, ajo do të ndjekë ecurinë e projektit dhe do të kërkojë raportim periodik me shkrim, jo më pak se dy herë në vit.

Shoqata Kulturore Patriotike "Kolonja" do të jetë përgjegjëse për organizimin dhe koordinimin e procesit të hartimit të enciklopedisë, administrimin e marrëdhënieve me autorët dhe grupet e punës, si dhe për garantimin e ruajtjes dhe administrimit të dokumentacionit përkatës.

Redaksia Qendrore dhe redaksitë e fushave do të mbajnë përgjegjësi për cilësinë shkencore dhe përmbajtjen e enciklopedisë, përzgjedhjen e autorëve dhe materialeve, si dhe përgatitjen përfundimtare për botim.

Administrimi i fondeve për realizimin e projektit do të kryhet mbi bazën e një protokollit të veçantë bashkëpunimi ndërmjet palëve.

Afati i realizimit të projektit është përcaktuar për periudhën 2025–2030.

Duke qenë se projekti paraqet rëndësi të veçantë për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike të zonës, propozohet miratimi i tij nga Këshilli Bashkiak.

**PUNOI:** Kleada Saliko

**PRANOI:** Eni Duro

**KONFIRMOI:** Drejtori D.Ç.J.P.P O.LIFO